

URDHËR
Nr. 5548, datë 7.8.2012

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, nenit 27 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave për miratimin e urdhër/programeve për “pritje, përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja”, në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 243, datë 15.5.1995 “Për shpenzimet për pritjen, përcjelljen dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja”, të ndryshuar, Sekretarit të Përgjithshëm.

2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse dhe Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Zhvillimit dhe Integrimit, për hartimin, zbatimin e procedurave mbi programet për pritjen, përcjelljet dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja.

3. Urdhri nr. 652/1, datë 1.10.2009 “Për delegim kompetence” revokohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BRENDSHËM
Flamur Noka